

VENDIM
Nr. 120, datë 13.3.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 926, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE
QË PRIVATIZOHET APO TRANSFORMOHET DHE PROCEDURËN E SHITJES”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 32, e kreut III, “Procedura e shitjes së pronës shtetërore”, të vendimit nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, riformulohet si më poshtë vijon:

“32. Pasuritë shtetërore, të dhëna me kontratë qiraje ose enfiteozë, me sipërfaqe mbi 500 (pesëqind) m², i shiten në mënyrë të drejtpërdrejtë kontraktuesit nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, sipas përcaktimeve të objektit të kontratës (objekt, truall nënobjekt, truall funksional, linja teknologjike, makineri, pajisje etj.):

a) pasi është konsumuar, të paktën, mbi 5 (pesë) vjet kontrata; në rast se vlera e investimit të kryer prej tij është mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) për qind të vlerës së truallit dhe kur nga ana e kontraktuesit janë respektuar kushtet e kontratës dhe ai nuk ka detyrime ndaj shtetit;

b) pa u përmbushur afati prej 5 (pesë) vitesh i konsumimit të kontratës, në rast se vlera e investimit të kryer prej tij është mbi 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) për qind të vlerës së truallit; nga ana e kontraktuesit janë respektuar kushtet e tjera të kontratës dhe ai nuk ka detyrime ndaj shtetit.

Pasi investimet e kryera nga kontraktuesi janë miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë, ky i fundit urdhëron vazhdimin e procedurave të privatizimit për shitje të drejtpërdrejtë, sipas objektit të kontratës (objekt, truall nënobjekt, truall funksional, linja teknologjike, makineri, pajisje etj.) dhe ngre komisionin e vlerësimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Pasuritë shtetërore të dhëna me kontratë qiraje me tarifën 1 euro/kontrata, i shiten në mënyrë të drejtpërdrejtë kontraktuesit nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, sipas përcaktimeve të objektit të kontratës (objekt, truall nënobjekt, truall funksional, linja teknologjike, makineri, pajisje etj.):

a) pasi është konsumuar, të paktën, mbi 5 (pesë) vjet kontrata, në rast se vlera e investimit të kryer prej tij është mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) për qind e vlerës së truallit; nga ana e kontraktuesit janë respektuar kushtet e kontratës dhe ai nuk ka detyrime ndaj shtetit;

b) në çdo kohë, nëse kontrata është e vlefshme dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratë, në rast se vlera e investimit të kryer prej tij është mbi 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) për qind e vlerës së truallit; nga ana e kontraktuesit janë respektuar kushtet e tjera të kontratës dhe ai nuk ka detyrime ndaj shtetit.

Pasi investimet e kryera nga kontraktuesi janë miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë, ky i fundit i propozon Këshillit të Ministrave dhënien e miratimit për fillimin e procedurave të privatizimit të objektit, sipas përcaktimeve të kontratës (objekt, truall nënobjekt, truall funksional, linja teknologjike, makineri, pajisje etj.), duke parashikuar edhe shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, që ka miratuar kontratën e qirasë me tarifën 1 euro, pas nënshkrimit të kontratës së shitjes.

Nëse Këshilli i Ministrave miraton propozimin për fillimin e procedurave të privatizimit të

objektit, sipas përcaktimeve të kontratës, ministri përgjegjës për ekonominë urdhëron vazhdimin e procedurave të privatizimit për shitje të drejtpërdrejtë, sipas objektit të kontratës, dhe ngre komisionin e vlerësimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Në rastet kur objekti i marrë me qira apo enfiteozë ose me kontratë qiraje 1 euro është shembur plotësisht dhe mbi truallin e tij është ndërtuar një objekt krejtësisht i ri, apo në rastet kur objektit të marrë me qira/enfiteozë i janë bërë ndryshime, shtesa apo prishje të shumta (të miratuara me aktet ligjore përkatëse), që e bëjnë të vështirë vlerësimin real të tij, pasi objekti është tjetërsuar, vlerësimi i objektit të marrë me qira/enfiteozë ose me kontratë qiraje 1 euro si dhe genplani bëhen në bazë të dokumentacionit ekonomiko-teknik, që disponon institucioni shtetëror, i cili e ka në administrim objektin, në bazë të çdo dokumentacioni tjetër të mundshëm, që mund t'i shërbejë këtij vlerësimi, si dhe në bazë të kontratës së qirasë/enfiteozës dhe dokumentacionit përkatës, bashkëlidhur saj (genplani, procesverbali i dorëzimit, fotografitë e objektit në momentin e marrjes me qira etj.).

Për qiramarrësit që blejnë nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, objektin shtetëror (godinën + linja teknologjike, makineri e pajisje), të cilin e kanë me qira/enfiteozë apo kontratë qiraje 1 euro, sipas përcaktimeve të kësaj pike, shlyerja e vlerës së objektit (godinës + linjës teknologjike, makineri e pajisje) bëhet deri në 80 (tetëdhjetë) për qind të vlerës së saj me bono privatizimi apo me lekë privatizimi, sipas kërkesës me shkrim, të depozituar pranë kësaj drejtorie nga blerësi i objektit. Pagesa e vlerës së truallit, për pasuritë shtetërore të dhëna me qira/enfiteozë dhe kontratë qiraje 1 euro do të bëhet vetëm me lekë.

Për rastet kur objekti ka ish-pronar truall, vlera e truallit, sipas përcaktimeve të bëra në dosjen e privatizimit, i kalon pronarit për kompensim.”.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama